

URDHËR
Nr. 79, datë 17.3.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 2, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; germave “b” dhe ç”, të nenit 13 dhe germës “a”, të nenit 21, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe germës “a”, të pikës 1, të nenit 7 dhe germës “a”, të pikës 1, të nenit 30, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, znj. Alketa Çeli, Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për të kryer procedurat dhe nënshkruar akte në emër të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për të zgjidhur kontratën e qirasë me nr. 997/3 prot., datë 26.9.2024, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
 2. Znj. Alketa Çeli nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca.
 3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.
 4. Urdhri nr. 195, datë 23.9.2024, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sokol Çomo